VENDIM
Nr. 90, datë 6.4.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME PAKICË)

(Ndryshuar me vendimin nr. 172, datë 16.8.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, germa "c", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe nenit 4, pika 1, germa "c"; nenit 5 dhe nenit 12, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 97, datë 4.7.2017, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/7 prot., datë 2.4.2021 dhe atë nr. 40/7-1 prot., datë 5.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7362 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/8 prot., "Albpetrol" sh.a., datë 24.12.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të depozitimit të dokumentacionit, në lidhje me aplikimin për licencën e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë) me 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 31.12.2020, pasi ky ka qenë afati i përcaktuar në vendimin nr. 120/2020, brenda të cilit duhej të depozitonte dokumentacionin e munguar e më pas deri në datën 6.1.2021, u konsiderua koha që ERE-s i duhej për të përgatitur praktikën për trajtim në Bord.

- Në vijim të kësaj kërkese, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 11.1.2021, vendosi për zgjatjen e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 6.1.2021 deri në datën 6.4.2021.

- Shoqëria "Albpetrol" sh.a., me shkresat e protokolluara në ERE nr. 120/1 prot., datë 29.3.2021, nr. 120/2 prot., datë 29.3.2021 dhe nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka përcjellë kryesisht dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria "Albpetrol" sh.a. ka kryer pagesën e aplikimit, sipas kërkesave të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit nr. 97, datë 4.7.2019.

- Aplikimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", si më poshtë:

- neni 9, "Formati i aplikimit";

- pika 1, germat "a", "b", "c": plotësuar.

- germa "d", "Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor", pikat "i", "iii", "iv", "v": plotësuar.

- germa "e", "Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale", pikat "i", "ii", "iii", "iv", "v", "vi", "vii": plotësuar.

- pika 2, "Dokumente specifike për llojin e licencës", germa "f", "Licencë për furnizim me gaz natyror", pikat "i", "ii", "iii": plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin e paplotësuar dhe atë të plotësuar pjesërisht si më poshtë, në këtë vendim do të përcaktohen kushte:

Neni 9, pika 1, "Forma e aplikimit":

- Germa "d", "Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor"

ii) (Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare që nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.) Shoqëria nuk ka depozituar vërtetim të prokurorisë dhe as vërtetim të gjykatës për shoqërinë tregtare: plotësuar pjesërisht. Duke qenë se vërtetimet mbajnë data të hershme dhe si rezultat i ndërrimit të administratorit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë për administratorin e ri të saj, dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë, me data të përditësuara. Shoqëria "Albpetrol" sh.a., me shkresën nr. 2190/1 prot., datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka bërë me dije se ka aplikuar për këto vërtetime dhe do t'i depozitojë në ERE sapo t'i disponojë.

vi) (Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse: plotësuar pjesërisht.) Duke qenë se këto dokumente janë depozituar në ERE në formatin fotokopje dhe fotokopje të njësuar me vulën e vetë "Albpetrol" sh.a., vlerësojmë vendosjen e një kushti në dispozitivin e vendimit, në mënyrë që shoqëria t'i përcjellë ato në formën e kërkuar nga neni 8, pika 3, e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror".

- Germa "e", "Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale":

i. Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit: pa plotësuar. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente për këtë kërkesë të rregullores, por me shkresën nr. 2190/1 prot., datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka bërë me dije se ka aplikuar për këto vërtetime dhe do t'i depozitoje në ERE sapo t'i disponojë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

Të licencojë shoqërinë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar;

2. Shoqëria "Albpetrol" sh.a. duhet të depozitojë çdo 3 (tre) muaj në ERE çdo dokument pronësor dhe mjedisor që i shërben ushtrimit të veprimtarisë së licencuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

3. Shoqëria "Albpetrol" sh.a. të dokumentojë në ERE brenda 6 (gjashtë) muajve kryerjen e të gjitha pagesave ndaj institucionit të tatimeve.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti